REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 15084
Nr. i faq. Br. str. 27 Data: Datum: 16/05
KAMENICË/A 2022

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAMENICËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kamenicës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kamenicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Kamenicës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Te pagat dhe mëditjet, kemi evidentuar mos harmonizim mes orëve të mbajtura dhe pagesave të tyre duke rezultuar me mbi pagesë prej 29,297€;

A2 Dobësi në procesin e rekrutimit;

A3 Kemi evidentuar dy projekte kapitale në të cilat kishte pasur ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar apo në disa raste duke mos realizuar fare pozicionet e kontraktuara . Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) .

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kamenicës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kamenicës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kamenicës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kamenicës me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kamenicës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Kontrollet mbi shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të siguruar menaxhim më efektiv të projekteve kapitale, pasurive komunale, shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve dhe rekrutimit të stafit të ri si dhe llogarive të arkëtueshme për të parandaluar rritjen e vazhdueshme të tyre. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i shqyrtojmë këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, një (1) pjesërisht i përsëritur si dhe dy (2) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mos harmonizim orëve të kontraktuara dhe të mbajtura

Gjetja	Kontratat e punës përcaktojnë të drejtat dhe obligimet mes palëve, ndër të tjera përcaktojnë edhe fondin e orëve që punëmarrësi është i obliguar të mbajë si dhe pagën me të cilën ka të drejtë të kompensohet për fondin përkatës së orëve. Në 30 raste gjatë vitit 2021, kemi identifikuar se, stafi i komunës në sektorin e arsimit, gjendjen reale të orëve të mbajtura e kishin më të ulët se ajo e përcaktuar me kontratë. Në anën tjetër, kompensimi i pagave ishte bërë sipas orëve/pagave të përcaktuara me kontratë dhe jo sipas gjendjes reale të orëve të mbajtura. Rrjedhimisht kjo ka rezultuar me pagesa të parregullta në vlerë prej rreth 29,297€. Kjo gjendje ishte për shkak të mbylljes së disa shkollave si rezultat i reformës në sektorin e arsimit ku një pjesë e stafit të arsimit nuk e plotësonin fondin e orëve të kontraktuara. Jemi njoftuar se komuna gjatë vitit 2022 ka filluar me harmonizimin e kontratave sipas gjendjes reale të orëve të mbajtura.
Ndikimi	Pagesa e stafit për orët e punëve të cilat nuk janë mbajtur, paraqet mos respektim të kontratës dhe reflekton në rregullsinë e pagesave.
Rekomandimi A1	Kryetari të ndërmarrë veprimet e nevojshme për azhurnimin e kontratave sipas gjendjes reale të orëve të mbajtura nga stafi në sektorin e arsimit, pastaj të sigurojë se kompensimet bëhen vetëm sipas pagës/orëve të përcaktuara me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Dobësi në procesin e rekrutimit

Gjetja	Neni 6.5 i Udhëzimit administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik përcakton se "Konkursi publik duhet të përsëritet nëse së paku tre kandidatë nuk i plotësojnë kriteret e shpallura me konkurs". Po ashtu, konkursi publik ndër të tjera përcakton kushtet e pjesëmarrjes në procesin e rekrutimit, kohëzgjatjen e emërimit si dhe kriteret të cilat duhet të plotësohen nga kandidatët e suksesshëm. Kemi evidentuar një rast në të cilin komuna nuk ka rishpallur konkursin për pozitën e Mësimdhënësit të Teknologjisë Informative (TIK) ndonëse nuk ekzistonin tre kandidat që i plotësonin kriteret për këtë pozitë. Përveç kësaj, kualifikimi i kandidatit të përzgjedhur ishte Bachelor me 180 kredi përderisa me konkurs ishte kërkuar kualifikimi Bachelor 240 kredi - sistemi katërvjeçar. Ndonëse për këtë pozitë komuna kishte lidhur kontratë me afat të caktuar deri me dt. 30.06.2021, kompensimi i pagës për pozitën në fjalë nuk ishte ndërprerë pas skadimit të kontratës por kishte vazhduar edhe për dy muajt vijues (korrik dhe gusht 2021), pastaj në shtator i është bërë kontratë e re (pa asnjë procedurë të konkursit) deri fund të viti 2021. Vlera e kompensimit për periudhën pa kontratë dhe kontratën e vazhduar pa procedura është prej 2,527€.

Kjo gjendje ishte për shkak se komisioni nuk kishte respektuar dhe vlerësuar drejtë kërkesat ligjore dhe kriteret e konkursit publik si dhe për shkak të dështimit të kontrolleve në menaxhimin dhe përcjelljen e ndryshimeve në paga.

Ndikimi Mos përmbushja e kritereve gjatë procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve rrit rrezikun që të jetë angazhuar personi jo meritor për pozitën e kërkuar. Ndërsa kompensimet pa kontrata si dhe vazhdimet e kontratave pa procedura rezultojnë në pagesa të pa rregullta duke e dëmtuar në këtë mënyrë buxhetin e komunës.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se janë zbatuar më përpikëri kërkesat ligjore dhe kriteret e konkursit në proceset e rekrutimit të stafit, në mënyrë që të pranohen kandidatë meritor në bazë të kushteve të përcaktuara. Po ashtu, me qëllim të parandalimit të pagesave të pa rregullta duhet të shtohen kontrollet në evidentimin e ndryshimeve mujore në listat e pagave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Ndryshime në pozicionet e kontratave pa aprovimin paraprak të ZKA-së

Gjetja Neni 61.21 Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RrUOPP) specifikon se "Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer", neni 61.22 thotë se "ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit", ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet "vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtarit Kryesor Administrativ".

Kemi evidentuar dy kontrata në të cilat kishte pasur ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar apo në disa raste duke mos realizuar fare pozicionet e kontraktuara, por pa e rritur çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga Zyrtari Kryesor Administrativ ashtu siç kërkohet me nenin 61 të RrUOPP.

Përkatësisht, te kontrata "Asfaltimi i 12 rrugëve dhe mbushja e gropave me asfalt" prej 204,617€, ndryshime të sasive kishte në 126 pozicione të kontraktuara, ndërsa tetë (8) pozicione në vlerë 2,530€ nuk ishin realizuar fare. Po ashtu, te kontrata "Rregullimi i shtratit të përroit Ruboc-Kamenicë" prej 106,277€, ndryshime të sasive kishte në 30 pozicione të kontraktuara, përderisa, gjashtë (6) pozicione në vlerë 6,704€ nuk ishin realizuar fare.

Nevoja për ndryshime kishte ardhur për shkak të specifikave të projekteve, ndërsa mos aprovimi i këtyre ndryshimeve ka ndodhur për shkak se menaxherët e projekteve nuk ishin në njohuri për kërkesat ligjore të prokurimit publik për ndryshimet e kontratave.

Ndikimi Ndryshimi i sasive së paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar pa aprovimin e ZKA-së shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë dhe mund të rezultojë që për shkak të realizimit të kontratës me kushte të ndryshuara nuk është përzgjedhur operatori më i lirë.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me

kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve) dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollet e brendshme në raportimin financiar

Pasqyrat financiare vjetore (PFV) të komunës të përgatitura me datë 31.01.2022 për vitin e përfunduar me 31.12.2021, nuk ishin në pajtim me Rregullën Financiare nr. 01/2017. Ato ishin jo të plota dhe të pasakta, prandaj ne gjatë procesit të auditimit kemi kërkuar nga menaxhmenti i komunës që PFV-të të korrigjohen. Pas kërkesës sonë, pasqyrat janë korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA dhe çështjet e ngritura nga ne janë korrigjuar. Mirëpo, gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në shpalosjen e llogarive të arkëtueshme e cila është trajtuar me poshtë.

Çështja A4 - Nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Gjetja	Neni 16 i Rregullores 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore thotë se: Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave. Kemi evidentuar se llogaritë e arkëtueshme ishin të nënvlerësuara për 147,989€. Përkatësisht, nuk ishin shpalosur të dhënat për të arkëtueshmet nga lejet ndërtimore 70,194€ si dhe nga shfrytëzimi i pronës publike prej 77,795€. Kjo gjendje ishte për shkak të gabimit teknik gjatë korrigjimit të PFV-ve, pasi që në versionin e parë të PFV-ve ato ishin shpalosur.
Ndikimi	Mos shpalosja e llogarive të arkëtueshme nga lejet ndërtimore dhe shfrytëzimi i pronës publike ka ndikuar në nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme për vlerën e mos prezantuar.
Rekomandimi A4	Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme për të siguruar se informatat lidhur me shpalosjen e tyre janë të plota dhe të sakta në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 62,964,113€, pasurive jokapitale është 279,416€, ndërsa vlera stoqeve ishte 850€.

Çështja A5 - Gabime në regjistrimin e pasurive kapitale

Gjetja

Sipas Nenit 11 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, pasuritë që gjenden në fazën e investimeve në vijim duhet të regjistrohen në kategorinë e investimeve në vijim, si dhe pas përfundimit të investimit pasuria duhet të klasifikohet si pasuri në përdorim.

Te kontrata "Asfaltimi i rrugëve në Kamenicë dhe fshatra" prej 218,168€ si dhe aneksi i kësaj kontrate prej 21,227€, kemi evidentuar se regjistrimi i pagesave prej 194,151€ (44,151€+35,547€+114,452€) ishin regjistruar si investim në vijim, ndërsa vlera prej 45,128€ ishte regjistruar si pasuri në përdorim, përderisa kontrata ishte përmbyllur dhe regjistrimi ishte dashur të bëhej me totalin e pagesave/kontratës si pasuri në përdorim në vlerë 239,229€.

Po ashtu, te kontrata "Kanalizimi në qytet dhe fshatra" prej 190,778€, kemi evidentuar se pagesat prej 50,965€ (42,026€+8,939€) ishin regjistruar si pasuri në përdorim, përderisa projekti ende nuk kishte përfunduar dhe duhet të ishte regjistruar si investim në vijim.

Regjistrimet e gabuara kryesisht ishin për shkak të volumit të madh të punëve në fund vit, pakujdesisë së zyrtarit të pasurive dhe mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi A5

Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja

Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se çdo fundvit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe, rrjedhimisht, nuk dihet diferenca mes gjendjes se kontabilitetit dhe

inventarizimit. Po ashtu, nuk ishte bërë fare vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të nenit 21 të Rregullores 02/2013.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

Ndikimi Mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi B1 Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive

Gjetja Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare thotë se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin E-pasuria.

Kemi evidentuar pagesa të shpenzimeve kapitale dhe jo kapitale prej 126,039€ të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive jo financiare, prej tyre tetë (9) pagesa me vlerë 105,864€ nuk janë regjistruar në SIMFK dhe tre (3) pagesa prej 20,175€ në E - pasuria.

Duhet theksuar se komuna ka bërë disa përmirësime në regjistrin kontabël të pasurive, ngase opinioni i auditimit të vitit paraprak ishte ndikuar për shkak të çështjeve të ngritura në fushën e pasurive.

Sipas zyrtarëve për regjistrimin e pasurive, mos regjistrimi i të gjitha pasurive kishte ndodhur për shkak të volumit të madh të punëve në fund të vitit si dhe për shkak të mos funksionimit të sistemit E pasuria.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi C1 Kryetari, duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar në regjistrat përkatës të pasurive komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,123,197€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në komunale në biznes dhe qiraja.

Çështja B2 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove dhe sipas nenit 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Në anën tjetër sipas rregullores 01/2016 për ngarkesa, taksa tarifa dhe gjoba komunale, neni 8 pika 8 parasheh se tarifat janë vjetore dhe paguhen në dy këste (kësti i parë deri me 15 qershor dhe kësti i dytë deri me 15 dhjetor).

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti (përveç të arkëtueshmet nga shfrytëzimi i pronës publike të cilat ishin zvogëluar për rreth 3%). Krahasuar me vitin paraprak rritja totale e të arkëtueshmeve ishte rreth 111,247€ apo rreth 5%. Pjesa më e madhe e LI. A i takon tatimit në pronë në vlerë 1,672,448€ rreth 74%, taksa komunale në biznes në vlerë 423,669€ rreth 19%, shfrytëzimi i pronës publike në vlerë 77,795€ rreth 3%, lejet e ndërtimit 70,194€ apo 3% si dhe qiratë 27,080€ apo rreth 1%.

Përveç tatimit në pronë, të gjitha llogaritë tjera të arkëtueshme menaxhohen në excel dhe si pasojë e kësaj të dhënat e prezantuara mund të mos japin siguri të plotë për saktësinë dhe plotësinë e tyre.

Rritja e llogarive të arkëtueshme vit pas viti ishte për shkak të mos marrjes së të gjitha veprimeve të mundshme për arkëtimin e tyre. Ndonëse niveli i ulët i arkëtimit ishte edhe si rezultat i ndikimit të pandemisë.

Ndikimi

Mos aplikimi i mekanizmave të përcaktuar me ligj dhe rregullore përkatëse ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, që rezulton me fonde më të pakta për arritjen e synimeve dhe mund të ndikoj edhe tek debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

Rekomandimi B2

Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[4]	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**10,725,420**	**10,929,744**	**10,015,180**	**9,516,804**	**9,050,689**
Grante Qeveritare - Buxheti	9,924,961	9,676,070	9,238,751	8,614,281	7,979,945
Financimi përmes huamarrjes	0	30,611	30,611	73,710	6,035
Të bartura nga viti i kaluar	0	287,686	178,039	257,672	296,660
Të hyrat vetanake	800,459	800,459	531,732	558,386	696,648
Donacionet vendore	0	53,076	36,047	12,756	71,401
Donacionet e jashtme	0	81,841	0	0	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 204,324€. Kjo rritje ishte rezultat i rritjes së të hyrave të bartura nga viti paraprak për 287,686€, rritjes së donacioneve të brendshme për 53,071€, rritjes së financimit nga huamarrja prej 30,611€, donacioneve të jashtme për 81,846€, përderisa buxheti nga granti qeveritar ishte zvogëluar për 248,891€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**10,725,420**	**10,929,744**	**10,015,180**	**9,516,804**	**9,050,689**
Pagat dhe mëditjet	7,300,000	7,220,505	7,208,601	7,169,057	6,876,338
Mallrat dhe shërbimet	1,354,350	1,493,469	1,151,631	1,058,131	787,975
Komunalitë	195,000	198,870	196,826	172,612	185,833
Subvencionet dhe transferet	211,000	283,584	282,724	383,499	200,813
Investimet Kapitale	1,665,070	1,733,315	1,175,398	733,504	999,731

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

• Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 79,495€. Zvogëlimi ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë prej 329,508€ dhe 51,368€ për të mundësuar harmonizimin e ndarjeve buxhetore të kategorisë së pagave dhe shtesave për muajin dhjetor 2021 si dhe kategorive tjera të shpenzimeve. Ndërsa rritja e buxhetit të pagave ishte për shkak të rishikimit të buxhetit prej 188,074€, rritjes nga të hyrat e bartura nga viti paraprak prej 13,809€, rritjes sipas vendimit të Qeverisë nga huamarrja prej 28,787€ si dhe rritjes së buxhetit nga fondi emergjent në kuadër të programit të rimëkëmbjes ekonomike prej 70,712€;

• Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 139,119€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura për 136,191€, nga huamarrja për 1,824€ si dhe donacionet e jashtme prej 1,604€. Përderisa buxheti ishte zvogëluar për 500€ për shkak të transferimit të dy inspektorëve në nivel qendror;

• Buxheti për shërbimet komunale ishte rritur për 3,870€ nga të hyrat e bartura të vitit paraprak; Buxheti për subvencione ishte rritur për 72,584€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura nga viti paraprak; dhe

• Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 68,245€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura për 61,232€, nga donacionet e brendshme 53,070€ si dhe donacionet e jashtme prej 80,242€. Duhet theksuar se buxheti i investimeve kapitale ishte zvogëluar sipas vendimit të Qeverisë për 126,300€ për të mundësuar harmonizimin e ndarjeve buxhetore të kategorisë së pagave dhe shtesave për muajin dhjetor 2021 si dhe kategorive tjera të shpenzimeve.

• Shpenzimet gjatë vitit 2021 për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ishin 248,472€. Ato janë realizuar nga programi për rimëkëmbje ekonomike dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave të stafit sipas vendimeve të nivelit qendror.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin 908,288€ apo rreth 42% më shumë se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës si në vijim: gjobat në trafik 125,394€, të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve 28,398€ si dhe gjobat nga gjykatat 80€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	**800,459**	**800,459**	**908,289**	**636,097**	**745,860**
Të hyrat tatimore	339,325	339,325	449,995	314,078	368,999
Të hyrat jo tatimore	461,134	461,134	458,294	322,019	376,862

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar në 5 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2021, dy (2) rekomandime janë zbatuar, një (1) pjesërisht i zbatuar si dhe dy (2) nuk ka filluar zbatimi, siç është paraqitur më poshtë në Grafikun 2. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se pasuria që nuk është nën kontroll të entitetit të largohet nga regjistrat e pasurisë, artikujt e blerë të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë si dhe në bashkëpunim më zyrtarët përgjegjës të cilët menaxhojnë sistemin e-pasuria të bëhet zhvlerësimi i saj.	Komuna ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim dhe ka bërë disa përmirësime në regjistrin e pasurive kontabël. Mirëpo edhe ne vitin 2021 kemi identifikuar pasuri kapitale dhe jo kapitale te cilat nuk ishin regjistruar ndonese kete vit nuk ndikohet opinioni i auditimit për këtë çështje.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët të cilët janë pjesë e komisionit të vlerësimit, të vlerësojnë aplikacionet në pajtim të plotë me kriteret e vendosura në Thirrjen Publike. Gjithashtu komisionet të mos përdorin kritere të cilat nuk kanë qenë të publikuara, janë diskriminuese, apo të cilat aplikuesit nuk dinë se duhet t'i plotësojnë.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla në vitin aktual.	I zbatuar
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.	Ishte përgatitur Plani Vjetor 2021 për mbështetje financiare për OJQ.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se inventarizimi i pasurisë të kryhet sipas rregullores në fuqi, ku pjesë përbërëse e raportit të inventarizimit të jetë edhe pasuria e cila është në përdorim nga zyrtarët komunal.	Edhe në vitin aktual kemi evidentuar mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, licencat e bizneseve dhe të borxheve të tjera dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.	Edhe në vitin aktual ka rritje të llogarive të arkëtueshme krahasuar me vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit

Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit

Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit

Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit

Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter konfirmimi - Kamenice 2021



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kamenicës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem në tërësi me gjetjet dhe rekomandimet në Draft Raport dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Kadri Rahimaj

Kryetar i Komunës

Data: 12.04.2022

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[5] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[6], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[5] Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[6] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[7] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.